



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM Nr.32 Date 06.07.2021


“ TRAJTIMIN ME BONUS STREHIMI ”

Mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenin 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 77, pika 10, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, Vendimin nr. 814, datë 03.12.2004, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, vendimin nr. 574, datë 29.08.2012, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, VKM Nr. 362 date 29.05.2019 Per kriteret e dhenies se subvencionit teqirase per kategorite qe gezojne perparesi ne subvencionimin e qirase ne tregun e lire, referuar shkreses nr. 456/4 prot date 07.04.2021 te derguar nga Ministria e Infrastruktures, Instituti I ndertimit te protokolluar nga ana jone me nr. 604/2 prot date 12.04.2021 si dhe raportit teknik nr. 456/3 prot date 07.04.2021, me propozim te Kryetarit të Bashkisë ne mbledhjen e Këshillit Bashkiak te dates 06.07. 2021 me 18 vota pro 2 vote kunder 0 apstenim

VENDOSI :

1. Lënjen në fuqi të vendimit 25 të datës 04.06.2021 të kthyer për rryshqyrtim nr.2000/1prot datë 22.06.2021.
2. Të miratojë bonusin për subvencionimin e qirasë për familjen e z. Miftar Murataj.
3. Efektet financiare do të përballohen nga buxheti i shtetit dhe buxheti bashkise ne masën 30 % të qerasë në vleren 4500 lek/muaj.
4. Ngarkohen Drejtoria e Ekonomike dhe Sektori i Administrimit te Pronave dhe Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi ka efekt nga momenti i hyrjes ne fuqi deri ne nje vit.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Diber.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.676/1.prot.

Peshkopi, më 21.07.2021

Lënda : Per vendimin nr.32, datë 06.07.2021 të Këshillit të Bashkisë Dibër

Drejtuar : KESHILLIT TE BASHKISE DIBER

PESHKOPI

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Diber nr.32, date 06.07.2021 "Për trajtimin me bonus strehimi të qytetarit Miftar Murataj", ardhur pranë nesh më datë 15.07.07.2021 e regjistruar me nr 676 prot, për vetë karakterin individual që prodhojnë akte administrative të kësaj natyre, vendosa të miratojë në parim vendimin objekt verifikimi dhe shqyrtimi, veprim që është përgjegjësi direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër.

